VENDIM
Nr.679, datë 2.11.2005

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 9 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr.8 "Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë", në listën "Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, duke paguar taksën e hyrjes (kur udhëtojnë me pasaporta të thjeshta)", të vendimit nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen shtetet:

"- Qipro;
- Maltë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha